



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **“MULTIMEDIA”**

**Niveli IV në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit IV të KEK<sup>2</sup>**

**T5-IV-21**

Tiranë më, 2021

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	MULTIMEDIA		Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli <b>IV në KSHK referuar nivelit IV të KEK</b>	<b>T5-IV-21</b>
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “ <b>Multimedia</b> ”, <b>niveli IV në KSHK</b> , referuar nivelit IV të KEK, është <i>zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre në nivelin e teknikut për multimedia, për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e ofruara në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe kryesisht në fushën e multimedias.</i>		
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Multimedia” të nivelit të katërt në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë mbaruar kualifikimin profesional “Teknologji informacioni dhe komunikimi”; nivelin II në KSHK, referuar nivelit IV të KEK;</li> <li>- janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional</li> </ul>		
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Multimedia”, <b>niveli IV në KSHK</b> , referuar nivelit IV të KEK e pajis individin me Certifikatën Profesionale suplementin përkatës të teknikut në këtë fushë. Pas nivelit të <b>IV në KSHK</b> , referuar nivelit IV të KEK, individ i fiton të drejtën e Diplomës së “Maturën Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare në degët e Informatikës, Teknologjisë së Informacionit, Elektronikës dhe jo vetëm. <p>Ky kualifikim i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës <i>për t’u punësuar apo vetëpunësuar në pozicionet e teknikut në multimedia si dhe pranë institucioneve e bizneseve të dimensioneve të ndryshme (në studio grafike, në kompanitë mediatike, në industrinë e printimit, në kompanitë e marketingut, në kompanitë e zhvillimit të websiteve dhe softuerë, në studio produksioni) etj.</i></p>		
<b>Data e validimit</b>	<i>(kur të miratohet)</i>		
<b>Data e miratimit</b>			
<b>Variantet e mëparshme</b>			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

## Rezultatet e të nxënit në:

### NJOHURI

Individi duhet të:

#### Menaxhimi dhe organizimi i punës

- Të përshkruajë sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, strukturën ekonomike dhe tendencat e zhvillimit të këtij sektori;
- Të shpjegojë organizimin në mënyrë ergonomike të vendit të punës;
- Të shpjegojë rregullat e komunikimit hierarkik;
- Të përshkruajë hapat e përshkallëzimit të proceseve të punës për zgjidhjen e problemeve dhe realizimin e detyrave;
- Të përshkruajë teknikat e negocimit, menaxhimit të mosmarrëveshjeve dhe arritjes së dakordësisë mes palëve;
- Të shpjegojë praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Të klasifikojë prioritetet në planin e punës;
- Të klasifikojë detyrat sipas veprimtarisë përkatëse;
- Të interpretojë detyrën sipas kërkesave dhe procedurave përkatëse të ndërmarrjeve;
- Të përshkruajë parimet e legjislacionit të punës dhe atij tatimor;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kodit të etikës;
- Të listojë burimet e nevojshme për realizimin e detyrave;
- Të shpjegojë llojet e ndryshme të materialeve të punës, karakteristikat dhe përdorimin e tyre
- Të shpjegojë llojet e ndryshme të mjeteve të punës, karakteristikat dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjeve të tërësisë së materialeve, mjeteve të punës dhe kohës së punës;
- Të përshkruajë përgatitjen e një preventivi sipas projektit;
- Të identifikojë hapat për mbikëqyrjen e ecurisë së një projekti sipas afatit në kohë dhe për ruajtjen e cilësisë;
- Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një shërbimi;
- Të përshkruajë rëndësinë zbatimit të rregullores së brendshme të biznesit;
- Të përshkruajë teknikat e marketingut;

#### Konceptim projekti

- Të përshkruajë mënyrë e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave;
- Të përshkruajë kategoritë e projekteve multimediale (Grafike, Animacion, Modelim

- 3D, Video, Audio, Fotografi) dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë elementët multimedial sipas projektit (tekst, fotografi, ngjyrat, audio, video, animacion);
- Të listojë teknologjitë sipas kategorisë së projektit;
- Të listojë llojet e mjeteve të punës për realizimin e një projekti;
- Të përshkruajë Softuerët dhe platformat e nevojshëm për realizimin e projektit multimedial;
- Të përshkruajë metodikat e vizatimit dhe skicimit;
- Të përshkruajë rezultatet e pritshme të projektit.

### **Dizenjim grafik**

- Të përshkruajë historinë e evolimit të dizajnit grafik;
- Të shpjegojë elementët e dizajnit grafik (tipografinë, paletat e ngjyrave, rolin e grid-it në dizajn, stilet e ndryshme të dizajnit grafik, Ilustrimin që përdoren në grafik dizajn);
- Të shpjegojë llojet e programeve dhe platformave për dizajnim grafik dhe përdorimet e tyre (Adobe Photoshop, In-Design dhe Illustrator etj.);
- Të shpjegojë teknikat e editimit të fotografive, imazheve etj. që përdoren në dizajnimin grafik;
- Të përshkruajë procesin UX (user experience) dhe përdorimin e tij;

### **Animacione**

- Të përshkruajë llojet softuerëve për animacionet si p.sh. (Macromedia Director, RAD 3D, CAD, Animator Pro, 3D Studio Max, Maya, Motion Video, blender etj. ) dhe mënyrën e përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë teknikat e ndërtimit të animacioneve 2D/3D;
- Të listojë elementët e animacionit 2D/3D;
- Të përshkruajë teknikat e animimit të tekstit;
- Të përshkruajë teknikat e animimit të fotove dhe imazheve;
- Të përshkruajë rëndësinë e përcaktimit të frame sipas skenarit të projektit të animimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përcaktimit të kohës së elementëve të animimit;
- Të përshkruajë llojet e animacioneve dhe përdorimet e tyre (Animacioni i karaktereve, imazheve, vizatimeve);
- Të përshkruajë tipet e audios (muzika, efektet e zërit, rrëfimi) dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë procesin e integrit të elementëve të animacionit në produktin final;

### **Realizimi i foto/video/audio**

- Të listojë aparatet e regjistrimit audio dhe vizual;
- Të përshkruajë përdorimet e aparateve të realizimit të fotografive;
- Të përshkruajë përdorimet e aparateve të regjistrimit audiove;

- Të përshkruajë përdorimet e aparateve të regjistrimit të videove;
- Të shpjegojë teknikat e fotografimit;
- Të shpjegojë teknikat e regjistrimit të audio/videove;
- Të shpjegojë përdorimet e softuerëve dhe platformave të përpunimit audio/video/fotografive;
- Të përshkruajë elementët e fotografive (afër, larg, dritë, ngjyra, kontrast rezolucion etj.) dhe rëndësia e tyre;
- Të përshkruajë specifikimet e elementëve të videove;
- Të përshkruajë specifikimet e audios;
- Të shpjegojë rëndësinë e paraqitjes të versioneve provizore;
- Të dallojë teknikat për rritjen e atraktivitetit të videove për shikuesit

### **Përmbajtja për media digjitale**

- Të përshkruajë kuptimin dhe llojet e mediave digjitale;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndjekjes së trendeve të fundit të mediave digjitale;
- Të listojë formatet e përmbajtjes së ndërfaqeve në media digjitale;
- Të listojë llojet e postimeve në mediat digjitale;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes dhe përdorimit të guidave për imazheve në mediat digjitale;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes dhe përdorimit të guidave për video dhe animacione në mediat digjitale;
- Të përshkruajë specifikimet e layout-it dhe përdorimet e një newsletter-i;
- Të përshkruajë llojet e krijimeve digjitale për radio dhe TV (sigla, reklama, video ilustruese etj.);

### **Përgatitja e produktit për prodhim**

- Të listojë formatet e ndryshme të skedarëve dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë llojet dhe specifikimet përkatëse të materialeve fizike që përdoren për prodhim (letër, tekstil, PVC, adeziv etj.);
- Të përshkruajë teknikat e përshtatjes së materialeve për prodhim;
- Të përshkruajë teknologjitë e printimit dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë teknikat e printimit në teknologji ofset;
- Të përshkruajë teknikat e printimit në teknologji dixhitale;
- Të përshkruajë teknikat e printimit 3D;
- Të përshkruajë teknikat e prodhimit të materialeve audio vizive;
- Të dallojë teknikat e testimit të produktit

### **Politikat e sigurisë dhe të drejtat e autorit**

- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të politikave dhe procedurave të sigurisë së informacionit të organizatës për pajisjet fizike, për software dhe të dhënat;

- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit dhe mirëmbajtjes së një bazë të dhënash me backup të produkteve multimediale, sipas udhëzimeve të sigurisë;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes së teknikave të watermarking (shënjimit) digjital për të mbrojtur të drejtat e autorit, për audio, video, imazh;
- Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të paketave softuerë të licencuar;
- Të argumentojë rëndësinë e asgjësimit në mënyrë të sigurtë të të dhënave sensitive dhe pronësore në pajisjet që dalin jashtë përdorimi;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e autorit;
- Të përshkruajë rëndësinë e raportimit të shkeljeve të politikave të sigurisë dhe të drejtave të autorit;

#### **Komunikimi në mënyrë etike**

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të Kodit të etikës;
- Të përshkruajë teknikat e punës në grup;
- Të listojë teknikat e zgjidhjes së problemeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e mendimit kritik;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK në komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;
- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit profesional në gjuhë të huajë;

#### **Rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit**

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të interpretojë standardet për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të përshkruajë masat dhe rregullat për garantimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Të listojë pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive dhe përdorimet e tyre gjatë punës;
- Të interpretojë manualët e përdorimit të pajisjeve;
- Të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë punës, si dhe mënyrën e shmangies së tyre;
- Të përshkruajë përmbajtjen e kutisë së MNZSH
- Të listojë llojet e mjeteve të ndihmës së parë;
- Të shpjegojë rregullat për dhënien e ndihmës së parë për personat që goditen nga rryma elektrike
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe procedurat e evakuimit në raste zjarri, tërmeti,

- fatkeqësi natyrore etj.;
- Të interpretojë sinjalistikën e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes e mbeturinave sipas llojit;
- Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes pastër të mjedisit të punës;

## **SHPREHI PROFESIONALE**

### **Menaxhimi dhe organizimi i punës**

- Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Të zbatojë detyrën sipas kërkesave dhe procedurave të organizatës;
- Të vendosë prioritete në planin e punës sipas projektit dhe rëndësisë së lëvrimit të detyrës;
- Të përdorë materialet dhe mjetet e nevojshme të punës sipas detyrës;
- Të planifikojë burimet e nevojshme për realizimin e detyrës;
- Të ndajë detyrat në ekip sipas veprimtarisë përkatëse;
- Të monitorojë punën sipas planit ditor, javor dhe mujor;
- Të raportojë për detyrën sipas procedurave;
- Të zbatojë kodin e etikës në organizatë;
- Të zbatojë parimet e legjislacionit të punës dhe atij tatimor;
- Të përdorë rregullat e komunikimit hierarkik;
- Të përcaktojë elementët e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një shërbimi;
- Të përgatisë një preventiv sipas projektit teknik;
- Të përcaktojë hapat për mbikëqyrjen e ecurisë së një projekti sipas afatit kohor dhe cilësisë;
- Të zbatojë teknikat e negocimit, menaxhimit të mosmarrëveshjeve dhe arritjes së dakordësisë mes palëve;
- Të zbatojë praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Të përdorë teknikat e marketingut;

### **Konceptim projekti**

- Të mbledhë të dhëna mbi projektin sipas natyrën e tij;
- Të analizojë të dhënat e mbledhura në funksion të projektit;
- Të ideojë mënyrën e realizimit të një projekti;
- Të përcaktojë hapat e punës për realizimin e projektit;
- Të përzgjedhë teknologjitë e duhura për realizimin e projektit;
- Të përcaktojë mjetet e nevojshme të punës;
- Të vizatojë/skicojë një model paraprak;
- Të paraqesë një prezantim të modelit paraprak;

- Të menaxhojë në mënyrë dinamike punën në raport me kohën dhe objektivat;

### **Dizenjim grafik**

- Të zbatojë tipografinë sipas specifikimeve të projektit;
- Të zbatojë paletat e ngjyrave sipas specifikimeve të projektit;
- Të zbatojë grid-ën në dizajn sipas specifikimeve të projektit;
- Të përzgjedhë stilet e ndryshme të dizajnit grafik;
- Të zbatojë Ilustrimin në dizajn;
- Të përzgjedhë llojet softuerëve dhe platformave për dizenjim grafik (Adobe Photoshop, In-Design dhe Illustrator etj.);
- Të zbatojë teknikat e përditësimit të fotografive në grafik;
- Të zbatojë teknikat e përditësimit të imazheve në grafik;
- Të zbatojë teknikat e përditësimit të objekteve në grafik;
- Të zbatojë teknikat UX (User Experience);

### **Animacione**

- Të përzgjedhë llojet softuerëve për animacionet si p.sh. (Macromedia Director, RAD 3D, CAD, Animator Pro, 3D Studio Max, Maya, Motion Video, blender etj. );
- Të zbatojë teknikat e ndërtimit të animacioneve 2D/3D sipas skenarit të projektit ;
- Të përzgjedhë elementët e animacionit 2D/3D;
- Të përzgjedhë teknikat e animimit të tekstit;
- Të përzgjedhë teknikat e animimit të fotove dhe imazheve;
- Të përzgjedhë formatet e frameve sipas skenarit të projektit të animimit;
- Të përcaktojë kohën e elementëve të animimit;
- Të përzgjedhë llojet e animacioneve sipas përdorimit e tyre (Animacioni i karaktereve, imazheve, vizatimeve);
- Të përzgjedhë tipet e audios (muzika, efektet e zërit, rrëfimi) sipas përdorimit të tyre;
- Të zbatojë procesin e integritit të elementëve të animacionit në produktin final;

### **Realizimi i fotografive/video/audio**

- Të përzgjedhë aparatet e regjistrimit audio - vizual;
- Të përdorë aparatet e realizimit të fotografive;
- Të përdorë aparatet e regjistrimit të audiove;
- Të përdorë aparatet e regjistrimit të videove;
- Të zbatojë teknikat e ndryshme të fotografimit;
- Të zbatojë teknikat e regjistrimit të audio/videove;
- Të përdorë softuerë dhe platforma të përpunimit audio/video/fotografive;
- Të përpunojë elementët e ndryshëm të fotografive (afër, larg, dritë, ngjyra, kontrast rezolucion etj.);
- Të përpunojë elementët e ndryshëm të videove;



- Të përpunojë elementët e ndryshëm të audios;
- Të prezantojë versione provizore;

### **Përmbajtja për media digjitale**

- Të hulumtojë mbi trendet e fundit të postimeve në media digjitale;
- Të hulumtojë mbi mjetet dhe editorët e krijimit të postimeve brenda platformave të media digjitale;
- Të zbatojë guidat në varësi të llojit të postimit dhe medias digjitale;
- Të përshtatë layout për e-mail, newsletter;
- Të përshtatë layout për web, blog, vlog etj.;
- Të përshtatë layout për transmetim në TV dhe në radio;
- Të testojë përmbajtjen digjitale;

### **Përgatitja e produktit për prodhim**

- Të koordinojë punën e tij me operatorin e prodhimit;
- Të përshtatë produktin për printim dixhital;
- Të përshtatë produktin për printim në ofset;
- Të përshtatë produktin për printim 3D;
- Të përshtatë produktin për prodhim në materiale të ndryshme si; tekstil, PVC, adeziv.
- Të vlerësojë cilësinë e produktit final krahasuar me materialin e përgatitur;
- Të hulumtojë mbi teknikat e reja të prodhimit të materialeve reklamuese, informuese etj.;
- Të zbatojë teknikat e duhura për prodhimin e materialeve audio vizive;

### **Politikat e sigurisë dhe të drejtat e autorit**

- Të zbatojë politikat e sigurisë në përdorimin e harduerë, softuerë dhe të dhënat sipas legjislacionit përkatës;
- Të kryejë backup periodike të produkteve multimediale sipas udhëzimeve të sigurisë së organizatës;
- Të krijojë shenjë sigurie digjitale (watermark) të produktit përfundimtar audio, video, imazh, sipas kërkesave për të mbrojtur të drejtat e autorit;
- Të përdorë paketa softuerë të licencuar;
- Të kryejë asgjësimin në mënyrë të sigurt të të dhënave sensitive dhe pronësore në pajisjet që dalin jashtë përdorimi;
- Të zbatojë legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e autorit;
- Të raportojë shkeljen e politikave të sigurisë dhe të drejtave të autorit sipas legjislacionit;

### **Komunikon në mënyrë etike**

- Të përdorë teknikat e komunikimit;
- Të zbatojë rregullat e Kodit të etikës;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të përdorë teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimin kritik;
- Të përdorë TIK në komunikim;
- Të përdorë terminologjinë e duhura profesionale në shqip dhe në gjuhë të huaj;
- Të respektojë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;
- Të përdorë teknikat e duhura për zgjidhjen e ankesave dhe konflikteve

### **Rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit**

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të monitorojë zbatimin manualeve përkatëse në përdorimin e pajisjeve;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
- Të respektojë sinjalistikën në terren;
- Të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të respektojë masat e mbrojtës gjatë punimeve në lartësi ;
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes personale në punë;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së distancave të rekomanduara në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat për mbrojtjen nga rrezatimet;
- Të zbatojë rregullat për mbrojtjen ndaj rrymave ose tensionit;
- Të verifikojë ndarjen e mbeturinave sipas llojit;
- Të zbatojë rregulla e mbrojtjes së mjedisit;

## **KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME**

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;

- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij
- Të demonstrojë proaktivitet në ngritjen e çështjeve dhe marrjen pjesë në diskutime për zgjedhje problemesh.